

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Primary Dental” Sh.P.K

Mbështetur në kushtetutën dhe Kodin Civil në Shqipëri, bazuar në Ligjin Nr.9901,date 14.04.2008’’PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE ‘‘NDRYSHUAR ME Ligjin Nr.10 475,date 27.10.2011 Per nje ndryshim ne Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 PER TREGTARET DHE SHOQERITE TREGTARE ‘‘ DHE LIGJIT Nr.9723, date 03.05.2007 per Q.K.R unë i nënshkruari ortaku I vetem **Z.Klajdi XHIXHO**, i datëlindjes **09.10.1986** lindur në Lubonjë, Korçë, me vullnetin tim të lirë,të shprehur edhe në nëshkrimin e këtij akt-themelimi sot në datën 05.09.2018, vendos të krijojë shoqërinë tregtare me përgjithësi të kufizuar “**Primary Dental**” Sh.P.K me akt themelimi si vijon:

Formulimi

Neni 1

Formohet shoqëria private e quajtur “Primary Dental” Sh.P.K e cila do të ketë selinë në **në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga “Muzakët”, Ndërtesa nr. 11, Objekti nr.6, Kodi 1016.**

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë , të krijojë filiale si Brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakut të vetëm .

Objektivi I Veprimtarisë


Neni 2

Shoqëria tregtare ushtron veprimtarinë: **Import-eksport; Materiale dhe pajisje spitalore dhe dentare; shitje me shumice dhe pakicë, etj.**

Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do te jete pa afat . Afati I veprimtarisë së shoqërisë, mund të ndryshojë, me vendim të shoqërisë.

Neni 4



Kapitali I Shoqerisë

Kapitali fillestar I shoqerisë private "Primary Dental" sh.p.k do të jetë 400.000 (katerqind mijë lekë).Kapitali është 100% nga kuota e ortakut të vetëm, e ndarë në 1 (një) kuotë . Kapitali themeltar fillestar mund të zmadhohet ose zvogëlohët sipas parshikimeve ligjore në fuqi.

Drejtimi I Shoqerisë

Neni 5

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj , përfaqesuesi ligjor i saj, Klajdi XHIXHO . Ai është përfaqesuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe ne rast mungesë nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme ose autorizim.

Neni 6

Fitimi që do të rezultojë nga veprimtaria e shoqerisë i takon tërësisht ortakut të vetëm të saj. Shoqëria nuk përgjigjet për humbjet e ortakut të saj jashtë veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 7

Ortaku i vetëm themelues ka te drejtë të emëroje dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale. Ka te drejtë te caktojë financiarë , likuidator për problemet e shoqerisë si dhe të pajtojë persona të tjerë,si ortakë .

Neni 8

Konfliktet që mund te lindin do të zgjidhen në zbatim te legjislacionit Shqipëtar në Gjykatën kompetente.

Neni 9

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë te normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi .

Neni 10

Akti I themelimit u përpilua në 4 kopje , për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqerise "Primary Dental" Sh.P.K.

Akti I themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakut i vetëm .

**Ortak i vetëm themelues i
"Primary Dental" Sh.P.K**

